




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Arsimit

04 Nr. 610/01-15909/24

Datë, 09.07.2024

Në bazë të Ligjit nr. 04/L- 032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria e Arsimit shpallë:

KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Gjimnaz dhe Shkollën Profesionale për vitin shkollor 2024/2025

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt
Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazëve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2024/25, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.
2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaz dhe shkollën profesionale, duhet të paragesin këto dokumente:

- Fletëparaqitja (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesa origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikata e lindjes.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaz dhe shkollë profesionale për vitin shkollor **2024/2025**, bëhet më datën **10, 11 dhe 12 korrik 2024**, në lokalet e shkollës anë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **08.00-16.00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën **13.07.2024**. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej **15 korrik 2024**. Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i parages ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHTI - Komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- | | | |
|--|-------|---------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (40%) | 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare në test | (20%) | 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) | 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë **100 pikë**.

4. Kriteri i lëndëve prioritare nga sukses i për gjimnaze është, që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë **4** (Së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

5. Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme është minimumi **40%** i pikëve nga ato lëndë.

Shih: Njoftimin e datës 27.06.2024, për kushtet, kriteret dhe afatet e regjistrimit të nxënësve në klasën e X-të, për vitin shkollor 2024-2025.

IAAP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" – Kaçanik

Drejtimi	Profili	Nr.i paral.	Nr.i nxën.
Makineri, prodhim dhe ndërtimtari	• Instalues elektrik	1	24
	• Instalues i ngrohjes, klimatizimit, ujësjesit	2	48
	• Automekanik	1	24
	• Metalpunues	1	24
	• Trafik rrugor	1	24
	• Informatikë	1	32
Teknologji e informacionit dhe komunikimit			
Ekonomi, administrim dhe juridik	• Administrim zyre dhe menaxhim	1	32
	• Kontablist	1	32
	• Tregti me pakicë dhe shumicë	1	32
	Gjithsej	10	272

Gjimnazi "Skënderbeu" - Kaçanik

Nr.	DREJTIMI	Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve
1.	Shkenca Natyrore	4	32 4x32=128
2.	Shkenca Shogërore-Gjuhësore	3	32 3x32=96
	Gjithsej	7	224

Drejtori / DKAS
Z. Zahir Doda

